



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI I LËNDËS
Gjuhë praktike e gjuhës B (1)

Ngarkesa: 8 kredite; 80 orë mësimore, 80 seminare

Viti / Semestri: Viti I/ Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor – Gjuhë, letërsi dhe qytetërim turk

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: adritik.derjaj@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Kjo lëndë synon mësimin e gjuhës turke nëpërmjet një metode të njohur. Lënda është e organizuar në seminare dhe shërben si praktikë për të zhvilluar kompetencat gjuhësore të studentëve në gjuhën turke Përdorimi dhe zbatimi i teorisë së strukturave gjuhësore në praktikë do të jenë qenësore, brenda dhe jashtë një konteksti të caktuar, thelbësore këto për procesin e mësimdhënies dhe të përkthimit.

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Të identifikojë dhe analizojë në mënyrë të detajuar të gjitha konceptet themelore të tilla si procesi i formimit të fjalëve të reja dhe i atyre ekzistuese;
- 2.Pjesët e ligjëratës dhe tipat e ndryshëm morfologjikë të fjalëve, bashkë me nën-kategorizimin e tyre; sistemin emëror dhe foljor etj.
- 3.Të jetë i aftë të identifikojë dhe veçojë konceptet dhe format themelore të strukturave gjuhësore të turqishtes

Rezultatet e pritshme:

- 1.Identifikojë dhe shpjegojë konceptet bazë të morfologjisë së gjuhës turke, si format e fjalëve, proceset e formimit të tyre dhe zhvillimin e kuptimit.
- 2.Analizojë pjesët e ligjëratës dhe tipologjitë morfologjike të fjalëve në turqisht, si dhe të kuptojë funksionin e tyre në ndërtimin e fjalive.
- 3.Përshkruajë dhe shpjegojë sistemin emëror dhe foljor të gjuhës turke, përfshirë lakimet, zgjedhimet, kohët, mënyrat dhe aspektet.
- 4.Zbatojë në mënyrë të saktë strukturat gjuhësore të turqishtes si në kontekste të izoluar (ushtrime gjuhësore), ashtu edhe në situata komunikimi praktik (shkrim e përkthim).
- 5.Analizojë fjali të ndërlikuara në gjuhën turke, duke identifikuar marrëdhëniet gramatikore ndërmjet elementëve të tyre.